



**RREGULLORE
PËR
ORARIN E PUNËS
TË PUNONJËSVE TË
K.R.U. „HIDROREGJIONI JUGOR“ SH.A. - PRIZREN**

Në bazë të nenit 7. pika 2. të Statutit të K.R.U. "Hidroregjioni jugor"Sh.A., dhe në përputhje me Ligjin e Punës 03/L-212, me datë **29.07.2016**, Bordi i Drejtorëve të K.R.U."Hidroregjioni Jugor"Sh.A.me seli në Prizren, aprovoi këtë:

RREGULLORE
MBI ORARIN E PUNËS TË PUNONJËSVE TË
K.R.U. „HIDROREGJIONI JUGOR“ SH.A - PRIZREN

ORARI PUNËS

Neni 1

Përcaktimi i orarit të punës

1. Orari i punës nënkupton periudhën kohore, gjatë së cilës i punësuar kryen punë ose shërbime në të mirë të Kompanisë.
2. Orari i plotë i punës zgjat dyzet (40) orë në javë, nëse me ligj nuk është përcaktuar ndryshe.
3. Orari i plotë i punës për të punësuarin, i cili është më i ri se tetëmbëdhjetë (18) vjeç, nuk mund të jetë më shumë se tridhjetë (30) orë në javë.

Neni 2

Orari jo i plotë i punës

1. Orari jo i plotë i punës, është orar pune më i shkurtër sesa orari i plotë i punës.
2. Marrëdhënia e punës mund të themelohet me orar jo të plotë pune, në kohë të caktuar dhe të pacaktuar.
3. I punësuar i cili punon me orar jo të plotë pune, i gëzon të gjitha të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga marrëdhënia e punës sikurse i punësuar me orar të plotë pune, në proporcion me orët e punës që ka punuar i punësuar.

Neni 3

Orari i shkurtuar i punës

1. Orari i shkurtuar i punës caktohet për punët dhe detyrat e punës, për të cilat edhe përkundër aplikimit të masave mbrojtëse, punëtori nuk mund të mbrohet nga ndikimet e dëmshme për shëndetin e tij.
2. Orari i punës shkurtohet në përpjesëtim me rrezikshmërinë për shëndetin dhe aftësinë punuese të punëtorit.
3. Orari i shkurtuar i punës mund të reduktohet më së shumti deri në njëzet (20) orë në javë, për punët me shkallë të lartë të rrezikshmërisë.
4. Punët dhe detyrat e punës nga paragrafi 1. i këtij neni përcaktohen në bazë të analizës profesionale nga organi kompetent, në pajtim me ligjin e punës, Kontratën Kolektive dhe me Aktin e Brendshëm të Punëdhënësi.
5. I punësuar i cili punon në punët dhe detyrat e punës nga paragrafi 1. i këtij neni, nuk mund të punojë në punë dhe detyra të njëjta jashtë orarit të punës.
6. I punësuar i cili punon me orar të shkurtuar të punës, sipas paragrafit 1. të këtij neni, i gëzon të gjitha të drejtat, sikurse të kishte punuar me orar të plotë të punës.

Neni 4

Puna më e gjatë se orari i plotë i punës

Puna shtesë mundë të kryhet si:

- a) punë shtesë e detyrueshme dhe
- b) punë shtesë vullnetare, në marrëveshje me punëdhënësin.

Neni 5

Puna shtesë e detyrueshme

Puna shtesë e detyrueshme kryhet:

- a. Në raste të jashtëzakonshme, me rritjen e vëllimit të punëve dhe në raste të tjera të domosdoshme, me kërkesën e punëdhënësit, punëtori duhet të punojë më gjatë se orari i punës (puna jashtë orarit), më së shumti deri në tetë (8) orë në javë.
- b. Puna më e gjatë se orari i plotë i punës, mund të zgjasë vetëm për aq kohë sa e kërkojnë rrethanat e paraqitura nga pika a. e këtij neni.
- c. Puna që e tejkalon kufirin e përcaktuar sipas pikës a. të këtij neni mund të bëhet edhe në rastet emergjente për parandalimin e aksidenteve ose forcave madhore të paparashikuara.
- d) Ndalohet puna jashtë orarit për të punësuarit nën moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeç, për të punësuarën gjatë kohës së shtatzënisë, prindin vetushqyes me fëmijë më të ri se tri (3) vjeç, ose me fëmijë të hendikepuar, dhe për gratë gjidhënëse.
- e) I punësuarit i cili punon me orar të shkurtuar të punës nuk mund të punojë më gjatë se orari i plotë i punës.
- f) Punëdhënësi është i obliguar të mbajë të dhëna të sakta për punët jashtë orarit dhe t'i prezantojë ato sipas kërkesës së Inspektoratit të Punës.
- g) Inspektori i Punës ndalon punën jashtë orarit, nëse ajo ndikon dëmshëm në shëndetin dhe aftësinë punuese të të punësuarit.
- h) Punëdhënësi është i obliguar të shpallë orarin e punës në vend të dukshëm.

Neni 6

Puna shtesë vullnetare

- a) I punësuarit mund të bëjë punë shtesë vullnetare në marrëveshje me punëdhënësin.
- b) Ndalohet puna jashtë orarit për të punësuarit nën moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeç, për të punësuarën gjatë kohës së shtatzënisë, prindin vetushqyes me fëmijë më të ri se tri (3) vjeç, ose me fëmijë të hendikepuar, dhe për gratë gjidhënëse.
- c) I punësuarit i cili punon me orar të shkurtuar të punës nuk mund të punojë më gjatë se orari i plotë i punës.
- d) Punëdhënësi është i obliguar të mbajë të dhëna të sakta për punët jashtë orarit dhe t'i prezantojë ato sipas kërkesës së Inspektoratit të Punës.
- e) Inspektori i Punës ndalon punën jashtë orarit, nëse ajo ndikon dëmshëm në shëndetin dhe aftësinë punuese të të punësuarit.
- f) Punëdhënësi është i obliguar të shpallë orarin e punës në vend të dukshëm.

Neni 7

1. Për punën më të gjatë se orari i plotë i punës, si dhe për punë në ditët e festave shtetërore dhe për punën e natës, i punësuarit ka të drejtë në pagë shtesë, në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive dhe Kontratën e Punës.

2. Të punësuarit i takon paga shtesë në përqindje të pagës bazë, si më poshtë:

- 2.1. 20 % në orë për kujdestari;
- 2.2. 30 % në orë për punë gjatë natës;
- 2.3. 30 % në orë për punë jashtë orarit;
- 2.4. 50 % në orë për punë gjatë ditëve të festave; dhe
- 2.5. 50 % përqind në orë për punë gjatë fundjavës.

3. Paga shtesë për punë gjatë fundjavës, festave dhe ditëve të lira sipas ligjit dhe rregullores së Kompanisë e përjashtojnë njëra-tjetrën.

4. I punësuar mund të kërkojë nga punëdhënësi që në vend të pagës shtesë nga paragrafi 2. i këtij neni, kompensimi t’i bëhet me ditë pushimi;
5. Kompania mund të vendosë që një pjesë të punës jashtë orarit të kompensohet me ditë pushimi, në përputhje me përqindjet e parapara në paragrafin 2. të këtij neni.

Neni 8 **Kufizimi i orarit të punës**

Në mënyrë që të shmangen reduktimet e punonjësve, apo, largimin kolektiv nga puna të të punësuarve, menagjmenti i Kompanisë mund të bëjë:

- kufizimin e punës jashtë orarit të punës dhe
- zvogëlimin e orëve të rregullta të punës;

Neni 9 **Ndarja dhe ndryshimi i orarit të punës**

1. Ndarjen e orarit të punës në kuadër të javës së punës e përcakton Kompania.
2. Java e punës mund të organizohet ndryshe, në rast se Kompania e organizon punën me ndërrime, gjatë natës ose kur natyra e punës në Kompani e kërkon një gjë të tillë.
3. menagjerët e Kompanisë, janë të obliguar që t’i informojnë të punësuarit për ndarjen dhe ndryshimin e orarit të punës, së paku shtatë (7) ditë para fillimit të punës.

Neni 10 **Ndryshimi i orarit të punës**

1. Menagjerët e Kompanisë, mund ta ndryshojnë orarin e punës kur e kërkon natyra e punës, si: organizimi i punës, shfrytëzimi racional i mjeteve të punës, shfrytëzimi racional i orarit të punës dhe kryerja e ndonjë pune të caktuar dhe të parashikuar me afat.
2. Në rastet nga paragrafi 1. i këtij neni, ndryshimi i orarit të punës bëhet në atë mënyrë që orari i punës i të punësuarit gjatë vitit kalendarik, të mos jetë më i gjatë se orari i plotë i punës.

Neni 11 **Ndalimi i zgjatjes së orarit të punës**

1. Ndalohet zgjatja e orarit të punës për të punësuarin i cili është më i ri se tetëmbëdhjetë (18) vjeç.
2. Punëdhënësi nuk mund të bëjë zgjatjen e orarit të punës për të punësuarën gjatë kohës së shtatzënisë, dhe prindin vetushqyes me fëmijë më të ri se tri (3) vjeç, ose me fëmijë të hendikepuar.

Neni 12 **Pushimi gjatë orarit të punës**

1. I punësuar ka të drejtë për pushim gjatë ditës së punës, me orar të plotë të pandërprerë të punës, në kohëzgjatje më së paku prej tridhjetë (30) minutash, i cili nuk mund të caktohet në fillim apo në mbarim të kohës së punës.
2. I punësuar i cili punon më gjatë se katër (4) orë, dhe më pak se gjashtë (6) orë në ditë, ka të drejtë për pushim gjatë punës në kohëzgjatje prej pesëmbëdhjetë (15) minutash.
3. I punësuar nën moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeçare i cili punon më së paku katër (4) orë e tridhjetë (30) minuta, ka të drejtë në pushim ditor në kohëzgjatje prej tridhjetë (30) minutash.
4. Koha e pushimit nga paragrafi 1. dhe 2. i këtij neni, konsiderohet si kohë e kaluar në punë.

Neni 13 **Pushimi ditorë**

1. I punësuar ka të drejtë në pushim ditor midis dy (2) ditëve të njëpasnjëshme të punës në kohëzgjatje prej së paku dymbëdhjetë (12) orë pa ndërprerë.
2. Gjatë kohës së punës, në punët stinore, punëtori ka të drejtë pushimi nga paragrafi 1. i këtij neni, në kohëzgjatje prej së paku njëmbëdhjetë (11) orësh pandërprerë.

Neni 14

Përshtatja e pushimit me procesin e punës

1. Në qoftë se natyra e punës nuk lejon që puna të ndërpritet, organizimi i pushimit gjatë ditës së punës bëhet në mënyrë që të mos shkaktohet ndërprerja e procesit të punës.
2. Vendimin për kohën e shfrytëzimit të pushimit gjatë ditës së punës e nxjerr punëdhënësi.

Neni 15

Puna e natës

1. Orët e punës ndërmjet orës 22:00 dhe 6:00 numërohen si punë nate.
2. Në qoftë se puna është e organizuar me ndërime, është e domosdoshme që të sigurohen ndërime të atilla që i punësuarit të mos punojë natën pa ndërprerë më gjatë se një (1) javë të punës.
3. Ndalohet puna e natës për personat nën moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeç dhe të punësuarat shtatzëna dhe gratë gjidhënëse.
4. Ndërrimet e natës mund të kryhen nga prindërit e vetëm dhe gratë me fëmijë më të rinj se tri (3) vjeç, ose me fëmijë me aftësi të kufizuara të përhershme, vetëm me pëlqimin e tyre.
5. Në qoftë se të punësuarit gjatë punës së natës, për shkak të punës së bërë sipas vlerësimit të organit kompetent shëndetësor, i përkeqësohet gjendja shëndetësore, punëdhënësi është i detyruar ta caktojë në punë të përshtatshme gjatë orarit të ditës.

Neni 16

Caktimi i të punësuarit në punët që janë me rrezik të shtuar

I punësuar nuk mund të caktohet që të punojë më gjatë se orari i plotë i punës apo në punë nate, nëse në bazë të konstatimit të organit kompetent për vlerësimin e gjendjes shëndetësore, një punë e tillë mund ta përkeqësojë gjendjen e tij shëndetësore.

Neni 17

Mbrojtja e amësisë gjatë orarit të punës

1. Femra e punësuar gjatë kohës së shtatzënisë, nëna me fëmijë nën moshën tri (3) vjeç, nuk mund të obligohet të punojë më gjatë se orari i rregullt i punës, dhe punë gjatë natës.
2. Prindi vetëshqyës, me fëmijë të moshës deri tri (3) vjeç dhe me fëmijë me invaliditet të rëndë, nuk mund të detyrohet të punojë më gjatë se orari i rregullt i punës dhe punë gjatë natës.
3. Të drejtat nga paragrafi 1. i këtij neni, mund t'i shfrytëzojë edhe adoptuesi i fëmijës, përkatësisht personi tjetër që kujdeset për fëmijën, në rast të vdekjes së dy prindërve të fëmijës ose nëse prindi e braktis atë.

Neni 18

Respektimi i orarit të punës

Punonjësit janë të detyruar që ta respektojnë orarin e punës të përcaktuar nga Kompania.

Punonjësit janë të detyruar që të nënshkruhen në listën e nënshkrimeve për rregullsinë në punë në kohën e fillimit të orarit të punës dhe në mbarim të tij.

Gjatë orarit të punës të punësuarit nuk guxojnë të largohen apo ta lëshojnë vendin e tyre të punës.

Gjatë orarit të punës punonjësit mund të largohen vetëm:

- në raste të lëndimit në punë ose sëmundjes;
- me njoftimin paraprak të mbikëqyrësit të tij të drejtëpërdrejtë;
- në rast rreziku për jetën, por vetëm deri në kalimin e rrethanave të tilla të paraqitura.

Neni 19

Në rast lëndimi në punë ose sëmundjes, si dhe në rast rreziku për jetën gjatë orarit të punës, punonjësi duhet ta informoj menjëherë udhëheqësin e tij të drejtëpërdrejtë ose bashkëpunëtorin e tij më të afërt, në mënyrë që vendi i punës të mos ngelet i pambuluar deri në fund të orarit të punës.

Neni 20

Mosrespektimi i orarit të punës

Përsëritjet e mosrespektimit të orarit të punës, mundë të sjellin deri te ndërprerjen e marëdhënjes së punës për të punësuarit.

Në rast të shkaktimit të dëmit material të shkaktuar Kompanisë si pasojë e mosrespektimit të orarit të punës, punonjësi detyrohet që dëmin e shkaktuar ndaj Kompanisë ta kompensoj.

Neni 21

Mungesa nga puna me pagesë

I punësuari ka të drejtë të mungojë nga puna me kompensim të pagës:

- pesë (5) ditë në rast të martesës së tij;
- pesë (5) ditë në rast të vdekjes së anëtarit të ngushtë të familjes, (babai, nëna, bashkëshorti, fëmijët si dhe fëmijët e adoptuar);
- tri (3) ditë për lindje të fëmijut dhe
- një (1) ditë pune për çdo rast të dhënies vullnetare të gjakut.

Neni 22

Mungesa nga puna me kompensim

1. I punësuari në rast të sëmundjes ka të drejtë në pushim mjekësor të rregullt mbi bazën, deri në njëzet (20) ditë pune brenda një (1) viti me kompensim prej 100 % të pagës.
2. I punësuari ka të drejtë në pushim mjekësor pa pagesë. Në bazë të kërkesës së të punësuarit, punëdhënësi mund të lejojë që i punësuari të mungojë nga puna pa kompensim të pagës.
3. I punësuari ka të drejtë në kompensim të pushimit mjekësor që është si pasojë e lëndimit ose sëmundjes profesionale në punë e cila ndërlihet me kryerjen e punëve dhe të shërbimeve për punëdhënësin me kompensim prej 70 % të pagesë.
4. I punësuari ka të drejtë në kompensim të pushimit mjekësor sipas paragrafit 3. të këtij neni në kohëzgjatje prej dhjetë (10) deri në nëntëdhjetë (90) ditë pune.
5. Pagesa për kompensimin e pushimit mjekësor bie mbi punëdhënësin.

Neni 23

Mungesa nga puna me kompensim për shkak të sëmundjes së rëndë

1. Përveq mungesës nga puna me kompensim sipas nenit 22, i punësuari ka të drejtë në mungesë nga puna me kompensim të pushimit mjekësor, dhe atë:
 - 1.1. gjashtë (6) muaj në rast të sëmundjes së rëndë, në emër të mjekimit me kompensim prej 70% të pagës;

1.2.në rastë se nuk shërohet (aftësohet) në periudhën kohore prej gjashtë (6) muajve sipas paragrafit 1. të këtij neni, atëherë i punësuar ka të drejtë në pushim mjekësor edhe për gjashtë (6) muaj tjerë për vazhdimin e mjekimit të mëtutjeshëm me kompensim prej 60% të pagës ;

Neni 24

Për të realizuar të drejtën nga neni 22, punëtori duhet që sëmundjen (paaftësinë) e tij të dëshmojë me dokumentacion mjekësor me të cilin përcaktohet diagnoza e dhënë nga mjekët adekuat, me qka dëshmohet se punonjësi vuan nga një sëmundje e rëndë dhe serioze, për shërimin e së cilës nevojitet periudhë më e gjatë kohore për mjekim.

Dokumentacioni i lartpërmendur duhet të konfirmohet edhe nga Mjeku Specialist i Mjeksisë së Punës.

Neni 25

Zbatimi

Dispozitat e kësaj Rregullore mbi orarin e punës së punonjësve të K.R.U. "Hidroregjioni Jugorë" Sh.A. në Prizren, do të zbatohen për të punësuarit në K.R.U. "Hidroregjioni Jugor"Sh.A., në Prizren.

Neni 26

Në rast konflikti me Ligjet në fuqi dhe Statutin e Kompanisë, dispozitat përkatëse të kësaj Rregulloreje konsiderohen të revokuara.

Neni 27

Interpretimin e Rregullores e bënë Shërbimi Juridik i K.R.U. "Hidroregjioni Jugor" Sh.A. në Prizren.

Neni 28

Kjo Rregullore e shfuqizon Manualin nr.01/28/01 të datës 13.10.2011, dhe hyn në fuqi 8 ditë pas miratimit nga Bordi i Drejtorëve të K.R.U. "Hidroregjioni Jugor" Sh.A. në Prizren.

Kryetari i Bordit të Drejtorëve


Rexhep Manxhuka

**Datë:08.08.2016,
Prizren**